HUGO BOSS

# KODI I SJELLJES SË FURNITORIT

**HUGO BOSS është i përkushtuar për respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit! Kodi i sjelljes së furnitorëve të HUGO BOSS rregullon bashkëpunimin me furnitorët e HUGO BOSS dhe sidomos sjelljen e punonjësit e tyre, pra ty. Në vazhdim ti gjen një pasqyrë të të drejtave dhe lirive që ti ke, të cilat punëdhënësi yt duhet ti akordojë ty. Ti ke të drejtën që të lexosh të gjithë kodin e sjelljes së furnitorëve, përveç kësaj duhet që punëdhënësi juaj të trajnojë ty për temat e përmendura këtu. Në rast ankesash, paqartësish ose pyetjesh ti mund ti drejtohesh në çdo kohë HUGO BOSS. Ne ju ndihmojmë me kënaqësi më tej!**

## KUSHTET E DENJA TË PUNËS

Si punonjës ti posedon të drejtën që të trajtohesh me respekt në vendin e punës. Dinjiteti, privatësia dhe personaliteti yt nuk lejohen të lëndohen.

## NDALIMI I PUNËS SË FËMIJËVE

Nuk lejohet të punësohen fëmijë! Si punonjës ti duhet të jesh të paktën 15 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyrueshëm.

## NDALIMI I PUNËS SË DETYRUAR

Si punonjës ti ke vendosur vetë dhe i lirë që të punosh këtu dhe ti nuk ke paguar tarifë për këtë gjë. Askush nuk lejohet të detyrojë ty që të punosh diku tjetër pa dëshirën tënde. Është zgjedhja jote, që të largohesh në çdo moment në përputhje me afatet nga vendi yt i punës. Dokumentet tuaja identifikuese të përkasin ty.

## LIRIA E GRUPIMIT & E DREJTA E TRAIFËS

Si punonjës ti lejohesh të anëtarësohesh në organizata punëmarrësish dhe të formosh organizata për qëllimet e punëmarrësve. Ti lejohesh të negociosh kushtet e punës, sidomos pagat, askush nuk lejohet që të dënojë ty për këtë gjë.

## RESPEKT & DINJITET

Si punonjës ti posedon të drejtën që të trajtohesh me ndershmëri dhe me drejtësi, pavarësisht moshës, gjinisë, ngjyrës së lëkurës, orientimit tënd seksual ose paaftësisë fizike, prejardhjes, kombësisë ose racës, besimit ose botëkuptimit, mendimit politik, përkatësisë te një shoqatë punëmarrësish ose karakteristika të tjera personale. Asnjë nuk posedon të drejtën të të ngacmojë ty seksualisht, të të prekë ose shajë. E njëjta gjë vlen edhe për abuzimin verbal ose mental.

## KOHËT E PUNËS

Në një javë normale pune ti nuk lejohet të punosh më shumë se 48 orë. Nëse bën orë shtesë, jo më shumë se 60 orë në javë. Orët shtesë duhet ti miratosh me dëshirë dhe duhet të paguhesh për to. Ti posedon të drejtën të kesh të paktën një ditë pushim në javë.

## SHPËRBLIM I NDERSHËM

Si punonjës ty duhet të paguhet të paktën paga ligjore minimale, në një javë të rregullt pune. Përveç kësaj ti posedon të drejtën e kërkesave ligjore në lidhje me shërbimet e veçanta, për shembull trajtimin me pagë kur jeni i sëmurë ose me leje lindje.

## SIGURIA & SHËNDETI

Punëdhënësi yt është përgjegjës, që vendi juaj i punës të jetë i sigurt dhe shëndeti juaj të mos rrezikohet, (p.sh. ndriçimi i keq ose zhurma.) Tualetet duhet të ndodhen në dispozicion të pastra dhe të ndara për burrat dhe gratë. Ti lejohesh të shkosh në çdo moment në tualet, punëdhënësi juaj nuk lejohet ta ndalojë ty këtë gjë ose ta rregullojë. Ti posedon të drejtën për një veshje mbrojtëse, nëse puna jote e kërkon këtë gjë.

## ETIKA E BIZNESIT

HUGO BOSS pret nga të gjithë furnitorët respektimin e ligjeve kombëtare dhe të **normave** ndërkombëtare në fuqi. Mashtrimi, korrupsioni si dhe akordimi i avantazheve jo të lejuara i të gjitha llojeve janë të ndaluara.

## MBROJTJA E MJEDISIT

Ndotjet e mjedisit, të cilat krijohen për shkak të aktiviteteve të biznesit duhet të reduktohen. Të paktën ligjet dhe përcaktimet për mbrojtjen e mjedisit duhet të respektohen. Resurset natyrore duhet të përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Mbrojtja e njeriut, kafshëve dhe mjedisit ka prioritet.

## Mekanizmi i ankimimit

Ti ke ankesa ose pyetje në lidhje me të drejtat, kushtet e punës tuaja ose të drejtat e njeriut? Drejtojuni sistemit të pavarur dhe falas të dhënies së indikacioneve të **HUGO BOSS.** Sistemi i dhënies së indikacioneve është i hapur për këdo dhe të gjithë! Kërkesa juaj do të trajtohet me konfidencialitet.

Skanoni kodin QR, për të shkuar te të dhënat e kontaktit (gjuhë të ndryshme):

Ose në linkun e mëposhtëm:
Speak Up Channel (convercent.com)

Shqipëri (Tiranë):
**4 454 1957**

© 2021 HUGO BOSS